



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2024:353566  
Datë: 04.02.2025  
Numri i dokumentit: 06801665

P.nr.377/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit L.A. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale *Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.641/24 e datës 10.12.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 03.02.2025, në praninë e prokurores së shtetit Vytyte Gërvalla dhe të pandehurit L.A., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 04.02.2025, me datë të njëjtë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: L.A., nga i ati A..., e ëma F..., e vajzërisë H..., data e lindjes... në Vushtrri, ku edhe tani jeton , me numër personal ..., i pa pune, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, edhe me parë i gjykuar për vepra penale të kësaj natyre, në vuajtje të dënimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 10.04.2024 rreth orës 15:50, minuta në Vushtrri, në bulevardin “Adem Jashari”, i pandehuri pa autorizim posedon substancë narkotikë, në atë mënyrë që njësia policore kishte qenë duke patrulluar, kishin vërejtur tani të pandehurin i cili kishte bërë lëvizje të dyshimta, dhe me rastin e kontrollimit të tij, tek i njëjti është gjendur një sasi e substancës narkotike e cila është sekuestruar dhe pas ekzaminimit, në laborator të Forenzikës është konstatuar se është substancë narkotike e llojit kanabis – marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 0.20 gram,

- Me këtë ka kryer veprën penale *Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe neni 269 par.1 të KPRK-së, si dhe neni 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: L.A. i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej shtatë (7) muaj, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej shtatëqind (700€) euro, të cilat dënime do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon ose nuk mund të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm nga Policia e Kosovës i substancës narkotike e llojit marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 0.20 gram,

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.641/24 e datës 10.12.2024 kundër të pandehurit L.A. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 03.02.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, i pandehuri L.A. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do e përsërisë më veprën.

### *Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në raport me veprën penale që i vihet në barrë dhe këtë pranim të fajësisë ta marr si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit ndërsa si rrethanë rënduese të ketë parasysh faktin se i pandehuri ka të kaluar kriminale pra nuk është hera e parë që bie ndesh me ligjin si dhe rrethanë tjetër rënduese të merret rrezikshmëria shoqërore që rezulton nga kjo vepër penale dhe pasojat që mund të shkaktohen në raport me shoqërinë. Po ashtu mbesim pranë propozimit si në aktakuzë që substanca të konfiskohet dhe të bëhet shkatërrimi i saj.

### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se

i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2024-BD-317, i datës 10.04.2024, raporti i oficerit, i datës 10.04.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin L.A., i datës 10.04.2024, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, i datës 10.04.2024, një fotografi në të cilën shihet substanca narkotike, raporti i ekspertimit nga AKF-ja, i datës 17.10.2024 si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 269 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen “*Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale dhe premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo veprë penale pasi që këto vepra penale janë në rritje e sipër në territorin ku është kryer kjo veprë dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre dhe te natyrave të tjera e cila është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykimin P.nr.130/2022 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 17.11.2022, për veprat penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, aktgjykimin P.nr.377/2021 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 11.01.2023, për veprën penale Vjedhja, aktgjykimin P.nr.335/2022 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 19.09.2023 për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, aktgjykimin P.nr.1/2024 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 20.09.2024 për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, dhe aktgjykimin P.nr.184/2022 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 30.10.2024 për veprën penale Posedimi

i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej shtatë (7) muaj, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej shtatëqind (700€) euro, të cilat dënime do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Urdhrin për konfiskimin e substancës narkotike gjykata e ka marrë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen.”

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.377/2024, datë 04.02.2025

GJYQTARI

Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.